REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:087303

Datë: 02.02.2021

Numri i dokumentit: 01466779

C.nr.706/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, e përbërë nga gjyqtari individual Naim MEHOLLI dhe gjyqtarët porot Enver RAMAXHIKU dhe Kimete FEJZA, me procesmbajtësen Elheme PECI, në çështjen juridiko-kontestimore, nga lëmia familjare, të propozueses V.K.B nga ..., tani me vendbanim në Fushë Kosovë, adresa: Rr.”...”, te rrethi, kati ... dhe propozuesit M.B nga Mitrovica, adresa: Rr.”...” P.N, baza e kontestit: Zgjidhje e Martesës, pas mbajtjes së seancës jo publike për shqyrtim kryesor me datë 02.02.2021, bie këtë:

A K T GJ Y K I M

I. **MARTESA** në mes të propozueses V.K.B, e lindur më ... në Istog, nga i ati ... dhe e ëma ... , dhe propozuesit M.B, i lindur më ... në Mitrovicë, nga i ati ... dhe e ëma ... , e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në Mitrovicë me datë 15.02.2016, me numër të referencës 11/2016RM/11001 dhe me numër rendor 89, **ZGJIDHET** sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve, në kuptim të nenit 68 dhe 69 të Ligjit për Familjen.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Procedura në këtë çështje në fillim u inicua me padinë e parashtruar nga ana e paditëses V.K.B kundër të paditurit M.B, mirëpo meqenëse padinë, në senacën për shqyrtim kryesor, nuk e kundërshtoi i padituri, padia e paditëses, në kuptim të nenit 68 par.4 të Ligjit për Familjen, u trajtua si propozim i përbashkët i bashkëshortëve për zgjidhje të martesës me marrëveshje.

Gjykata me datë 02.02.2021 ka caktuar dhe mbajtur seancën gjyqësore në këtë çështje.

Propozuesja në këtë seancë, deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, i propozoi gjykatës që t’a zgjidhë martesën dhe të njëjtën t’a liroj nga obligimet martesore pasi që ka afërsisht shtatë (7) muaj që të njëjtit e kanë shkëputur edhe bashkësinë faktike. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Propozuesi gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se nuk e kundërshton padinë për shkurorëzim, gjithashtu deklaroi se është i pajtimit që kjo martesë të zgjidhet ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

2020:087304

Në procedurën e provave, gjykata administroi këto prova: certifikata martesore nga Zyra e Gjendjes Civile në Mitrovicë, e lëshuar me datë 20.07.2020, kopja e letërnjoftimit për propozuesen.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku dhe nga të njëjtat vërtetoi këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se propozuesit kanë lidhur martesë në mes tyre me datë 15.02.2016, këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të certifikatës së martesës.

Meqenëse propozimi për shkurorëzim është bërë më marrëveshje, siç e parashohin edhe dispozitat ligjore, gjykata nuk e pa të arsyeshme të hetoj rreth shkaqeve të shkurorëzimit.
Sa i përket të drejtës materiale, gjykata u bazua në nenet 68, 69 dhe 84 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata vendimin e mori konform nenit 450 të LPK-së.
Aktgjykimi bazohet në nenin 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.706/2020 datë 02.02.2021

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES – GJYQTARI
Naim MEHOLLI

UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh që nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.